VENDIM
Nr.412, datë 26.5.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT, TË FORMËS "BOT" (NDËRTIM, OPERIM, TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË "BUSA" SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE "STRELCA 1", "STRELCA 2" DHE "STRELCA 3"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në kontratën e koncesionit, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë "Busa" sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve "Strelca 1", Strelca 2", Strelca 3", të miratuar me vendimin nr.718, datë 14.5.2008 të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS "BOT" (NDËRTIM, OPERIM, TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË "BUSA" SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE "STRELCA 1", "STRELCA 2" DHE "STRELCA 3", TË MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.718, DATË 14.5.2008

Në Tiranë, sot më datë_____ 2010, palët:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përcaktuar si "Autoriteti kontraktues" me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.128, datë 14.8.2007 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve "Strelca 1", "Strelca 2" dhe "Strelca 3 dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë" dhe përfaqësuar nga titullari z.Dritan Prifti, i datëlindjes_____ , madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta nr.

dhe

Shoqëria "Busa" sh.p.k., me seli në rrugën "Gjergj Fishta" Tiranë, regjistruar si person juridik me vendimin nr.33476, datë 9.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; regjistruar në organin tatimor me NIPT nr.K51912007W, datë 12.7.2005, që më poshtë do të quhet "Koncesionari", me administrator z.Mane Bulluti, i cili me prokurorë nr.1280 rep., nr.373 Kol. datë 22.2.2007, i jep të drejtën për të nënshkruar këtë marrëveshje z.Bujar Çeta, i biri i Skënderit, i datëlindjes 31.12.1966, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta Z 1427659, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, bien dakord si më poshtë:

Ta lidhë këtë marrëveshje, për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë "Busa" sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve "Strelca 1", "Strelca 2" dhe "Strelca 3", të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.718, datë 14.5.2008.

Palët bien dakord për këto shtesa dhe ndryshime të kontratës së koncesionit:

Neni 1

Në kontratën bazë të koncesionit, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.718, datë 14.5.2008:

-Kudo ku është shprehur "…hidrocentralet/eve "Strelca 1", "Strelca 2" dhe "Strelca 3", të zëvendësohen me "...hidrocentralet/eve "Strelca 1" dhe "Strelca 3".

Neni 2

Në nenin 1 "Përkufizime":

-Në pikën 1.5 fjalët "… me fuqi të instaluar të përgjithshme 8,300 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 37,653,492 kWh" zëvendësohen me fjalët "...me fuqi të instaluar të përgjithshme 4,100 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 14,700, 000 kWh".

Neni 3

Neni 3 zëvendësohet si më poshtë:

"Neni 3

Karakteristikat e hidrocentraleve "Strelca 1" dhe "Strelca 3"

Hidrocentrali "Strelca 1" do të ndërtohet në rrjedhën e përroit të Beleshit, në rrethin e Korçës, me këto karakteristika:

-Kuotat e veprave:
-Kuota e veprës së marrjes 1, 519 m;
-Kuota e godinës së centralit 1, 223 m;
-Prurja llogaritëse 0.74 m/sek;
-Fuqia e instaluar 1, 900 kW;
-Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 6, 800, 000 kWh.
-Vepra e marrjes në rrjedhën e përroit Verba, në rrethin Korçë, do të ketë këto karakteristika:
-Kuota e veprës së marrjes 1,543 m
Uji do të dërgohet me tubacionin në liqenin e Strelca 1.

Hidrocentrali "Strelca 3" do të ndërtohet në rrjedhën e përrenjve të Beleshit dhe të Verbës, në rrethin e Korçës, me këto karakteristika:

-Kuotat e veprave:
-Kuota e veprës së marrjes 1, 218 m;
-Kuota e godinës së centralit 810 m;
-Prurja llogaritëse 0.68 m/sek;
-Fuqia e instaluar 2, 200 kW;
-Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 7, 900, 006 kWh."

Neni 4

Në nenin 7, pika 3, shprehja "…në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës." hiqet.

Neni 5

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

Pika 2 zëvendësohet me "të paraqesë pranë autoritetit kontraktues për miratim projektin e zbatimit brenda 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje."

Në pikën 6, fjalët "…me fuqi të vendosur jo më pak se 8,300 kW" zëvendësohen me "…me

fuqi të vendosur jo më pak se 4,100 kW”.

Neni 6

Neni 9 “Vlerësimi i investimeve” zëvendësohet si më poshtë:

“Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 601 751 000 (gjashtëqind e një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë) lekë, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur, nga të cilat 133 723 000 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e shtatëqind e njëzet e tre mijë) lekë do të investohen në makineri e pajisje.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:

-pas variantit përfundimtar të projektzbatimit i cili mund të përmirësohet, por duke ruajtur të pandryshuar kuotat/termat e përcaktuara në këtë marrrëveshje;

-në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës;

Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 601 751 000 (gjashtëqind e një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë) lekë, por jo më e vogël se 571 663 450 (pesëqind e shtatëdhjetë e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 5% (pesë për qind) të investimit total të parashikuar.”.

Neni 7

Neni 10 pika 2 zëvendësohet me “2 Koncesionari merr përsipër ta vërë në punë hidrocentralin brenda 36 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur”.

Neni 8

Në nenin 14 “Sigurimi i kontratës” në paragrafin e parë, shprehja “…një shumë prej 108 400 000 (njëqind e tetë milionë e katërqind mijë) lekë …” “zëvendësohet me “… një shumë prej 60 175 100 (gjashtëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e njëqind) lekë…”

Neni 9

Në nenin 23 “Sanksionet”, bëhen këto ndryshime:

Në pikën 1. b, fjala “… në konkurrim…” zëvendësohet me “…në këtë marrëveshje…”.

Në pikën 2, fjalët “…në këtë kontratë…” zëvendësohen me “…në këtë marrëveshje…”

Në pikën 2.a, fjalët “… të prodhimit të energjisë elektrike prej 37,653,492 kWh/vit…” zëvendësohen me “…të prodhimit të energjisë elektrike prej 14,700, 000 kWh.vit…”.

Në pikën 2.b. fjalët “…sipas projektit të propozuar…” zëvendësohen me “…sipas kësaj marrëveshjeje…”

Neni 10

Ndryshimet dhe shtesat e përcaktuara në këtë marrëveshje hyjnë në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Nenet e tjera të kontratës bazë nuk kanë ndryshuar.

Kjo marrëveshje u hartua në 6 (gjashtë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

Palët

AUTORITETI KONTRATRAKTUES MINISTRIA E EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS **PËRFAQËSUAR NGA Z.DRITAN PRIFTI**	KONCESIONARI SHOQËRIA “BUSA” SH.P.K. **PËRFAQËSUAR NGA Z. BUJAR ÇETA**

PREVENTIVI PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE STRELCA 1 DHE 3

ANEKSI 1

Tabela përmbledhëse e preventivit HEC-Strelca -1					
Nr.	**Emërtimi i punimeve**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi**	**Vlefta**
				Lekë	**Lekë**
1	Vepra e marrjes	copë	2	50 000	100 000
2	Baseni i dekantimit	copë	2	30 000	60 000
3	Kanal derivacioni	ml	3000	45 000	135 000 000
4	Basen presioni	copë	1	50 000	50 000
5	Tubacioni i presionit	ml	1300	30 000	39 000 000
6	Godina e hidrocentralit	m^2	100	30 000	3 000 000
7	Linja elektrike		1	13 601 200	13 601 200
8	Turbina pelton&pajisjet N=1700 kw	kw	1700	32 615	55 446 122
			SHUMA		**246 257 322**

Tabela përmbledhëse e preventivit HEC-Strelca -3					
Nr	**Emërtimi i punimeve**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi**	**Vlefta**
				lekë	**lekë**
1	Vepra e marrjes	copë	1	50 000	50 000
2	Baseni i dekantimit	copë	1	30 000	30 000
3	Kanal derivacioni	ml	3500	45 000	157 500 000
4	Basen presioni	copë	1	50 000	50 000
5	Tubacioni i presionit	ml	3500	30 000	105 000 000
6	Godina e hidrocentralit	m^2	100	30 000	3 000 000
7	Linja elektrike		1	20 586 800	20 586 800
8	Turbina pelton & pajisjet N=2400 kw	kw	2400	32 615	78 276 878
			SHUMA		**364 493 678**

	Punime ndërtimore			Lekë	477 028 000
	Punime makineri pajisje (4100 KW)			Lekë	133 723 000
	Investimi total		**TOTAL**	**Lekë**	**610 751 000**

ANEKSI 2

GRAFIKU PËRMBLEDHËS I PUNIMEVE PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE STRELCA 1 DHE 3

Koha e vënies në shfrytëzim të hidrocentraleve (38 muaj)

			Viti 1						Viti 2						Viti 3					
	Objekti i ndërtimit		60	120	180	240	300	360	420	480	540	600	660	720	780	840	900	960	1020	1080
HEC-1	VEPëR MARRJE, DEKANTUS, BASEN PRESIONI																			
	TRASEJA SEG 1																			
	TRASEJA SEG 2																			
	NDëRTESA E CENTRALIT																			
HEC-2	VEPëR MARRJE, DEKANTUS, BASEN PRESIONI																			
	TRASEJA SEG 1																			
	TRASEJA SEG 2																			
	NDëRTESA E CENTRALIT																			
	LINJA E TRANEMSIMIT																			

Shuma totale e investimit 601751000 lekë

Ndërtimi do të përfundojë për 38 muaj.